



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më 02.03.2022

**V E N D I M**

**Nr. 80, datë 02.03.2022**

**PËR  
PROPOZIMIN PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË,  
TË KANDIDATIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 02.03.2022, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020, bazuar në rezultatet e procedurës së përzgjedhjes, si dhe mbasi shqyrtoi projektvendimin “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. {...}”,

**V Ë R E N:**

**I. MBI PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARIT**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar edhe si Këshilli), sipas pikës 1, të nenit 136, si dhe shkronjës “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të emërimin të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, nga radhët e gjyqtarëve dhe të juristëve të spikatur, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Ky funksion i Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet edhe në pikën 2, të nenit 85, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

2. Ndërkohë, emërimi në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), konsiderohet si ngritje në detyrë, çka përbën një nga institutet juridike të zhvillimit të karrierës gjyqësore, përgjegjës për të cilën është Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Neni 48 i Ligjit për Statusin përcakton se çdo pozicion i lirë në një gjykatë të një shkalle më të lartë ose të specializuar, plotësohet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, nëse, kur është rasti, ky pozicion nuk arrihet të plotësohet nëpërmjet lëvizjes paralele. Në rastin e Gjykatës së Lartë, referuar kuptimit dhe përmbajtjes së institutit juridik të lëvizjes paralele, ky instrument ligjor është i pazbatueshëm, sa kohë Gjykata e Lartë është gjykata e shkallës më të lartë në piramidën e organizimit të pushtetit gjyqësor, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sikurse edhe në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

4. Në kuadër të një procedure ngritjeje në detyrë, pra edhe atë të emërimit në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 48, të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor është i ngarkuar me përgjegjësinë e verifikimit të plotësimit nga kandidatët të kritereve të kandidimit, pra të emërimit në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe për renditjen e kandidatëve që plotësojnë kriteret, në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, pra të kandidatit më të mirë për atë pozicion të lirë, për të cilin organizohet procedura e ngritjes në detyrë. Për renditjen e kandidatëve, sipas meritës, kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar si kriter bazë atë të vlerësimit etik dhe profesional, i cili rregullohet nga nenet 68 e vijues, të Ligjit për Statusin.

5. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij për zhvillimin e karrierës gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, menjëherë pas ngritjes dhe fillimit të funksionimit të tij në Dhjetor 2018, duke vlerësuar si një çështje shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor atë të ngritjes në detyrë, në veçanti për Gjykatën e Lartë, çka ishte bërë prioritare dhe sensitive, hartoi dhe miratoi aktet nënligjore kryesore të autorizuara nga ligji, miratimi i të cilave do t'i hapte rrugë edhe ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, përfshirë edhe nga radhët e gjyqtarëve.

5.1 Konkretisht, me Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, përfshirë dhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, që përbën dhe fazën e parë të procedurës së ngritjes në detyrë.

5.2 Ndërsa me Vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, pra renditjen e tyre dhe identifikimin e kandidatit të renditur më lart, që përbën dhe fazën e fundit të procedurës së ngritjes në detyrë.

5.3 Ndërkohë, në funksion të renditjes së kandidatëve, që sikurse u përmend më lart, si kriter bazë ka atë të vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli miratoi Vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, si dhe Vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, nëpërmjet të cilëve plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

6. Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, kjo me qëllim për bërjen e kësaj të fundit funksionale në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht atyre të “*përvojës profesionale minimale*”, të “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*” dhe të “*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*”, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kriteret do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

## **II. PROCEDURA E NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 83, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

### **A. HAPJA E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË**

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër

të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020.

8. Në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020, afati i kandidimit u përcaktua “*dy muaj nga dita e publikimit e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*”. Ky vendim u publikua në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 28.02.2020, krahas edhe një njoftim publik. Pas këtij publikimi, nga dita e nesërme e tij, ka filluar të ecë afati i kandidimit.

## **B. KANDIDIMET**

9. Brenda afatit të kandidimit, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020, kandiduan gjithsej pesë kandidatë dhe konkretisht: 1) Znj. Manjola Xhaxho, 2) Z. Dhimitër Lara, 3) Z. {...}, 4) Znj. Klodiana Veizi dhe 5) Z. Sokol Ibi.

## **C. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

10. Procedura e verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit nga kandidatët për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020, filloi me Vendimin e tij nr. 201, datë 11.06.2020.

11. Fillimisht, sikurse u përmend në pikën 6, të këtij vendimi, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve formale të kandidimit, pikërisht të:

- 1) “*përvojës profesionale minimale*”, sipas pikës 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “*Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. ...*”, si dhe pikës 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar*”;
- 2) “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*”, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*8. Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”;

- 3) *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklarohet nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”*

12. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit, fillimisht, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin nga të pestë kandidatët të këtyre kritereve, duke vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Konkretisht, verifikimi i plotësimit nga kandidatët të tre kritereve formale të kandidimit, u vendos nga Këshilli: me Vendimin nr. 215, datë 18.06.2020, për kandidaten znj. Manjola Xhaxho, me Vendimin nr. 234, datë 02.07.2020, për kandidatin z. Dhimitër Lara, me Vendimin nr. 216, datë 18.06.2020, për kandidatin z. {...}, me vendimin nr. 214 datë 18.06.2020 për kandidaten Klodiana Veizi (Mema) dhe me vendimin nr. 211 datë 18.06.2020 për kandidatin z. Sokol Ibi.

13. Në vijim, Këshilli verifikoi plotësimin nga secili prej pesë kandidatëve të tjerë edhe të kritereve *“të pasurisë dhe figurës”*, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”*, si dhe: *“8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

14. Në përfundim të procedurës së verifikimit, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin nga të pestë kandidatët në garë të të gjithë kritereve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë.

14.1 Konkretisht, kualifikimi i pesë kandidatëve dhe vijimi për ata të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, u vendos nga Këshilli:

- a) me Vendimin nr. 602 datë 04.12.2020, për kandidaten znj. Manjola Xhaxho;
- b) me Vendimin nr. 380 datë 02.10.2020, për kandidatin z. Dhimitër Lara;
- c) me Vendimin nr. 600 datë 04.12.2020, për kandidatin z. {...};
- ç) me Vendimin nr. 371 datë 28.09.2020, për kandidaten znj. Klodiana Veizi (Mema);
- d) me Vendimin nr. 648 datë 29.12.2020, për kandidatin z. Sokol Ibi;

### **Ç. PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL**

15. Nga ana tjetër, siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët e kualifikuar kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) Procedura e vlerësimit me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin, filluar me Vendimin e Këshillit nr. 198, datë 11.06.2020; 2) Procedura e vlerësimit të përshpejtuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr. 48/2019, filluar me Vendimet e Këshillit nr. 247, datë 09.07.2020 dhe nr. 337, datë 24.09.2020.

16. Në përfundim të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli ka miratuar për secilin nga pesë kandidatët e kualifikuar, vlerësimet etike dhe profesionale për periudhat respektive të vlerësimit. Konkretisht:

- a) për kandidaten znj. Manjola Xhaxho, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 264 dhe nr. 265, datë 28.06.2021;
- b) për kandidatin z. Dhimitër Lara, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 202 dhe nr. 203, datë 20.05.2021;
- c) për kandidatin z. {...}, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 271 dhe nr. 272, datë 01.07.2021;
- ç) për kandidaten znj. Klodiana Veizi (Mema), vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 153 dhe nr. 154, datë 14.04.2021;
- d) për kandidatin z. Sokol Ibi, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 196, datë 12.05.2021 dhe nr. 197, datë 01.07.2021;

## D. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

17. Ndërsa procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurës tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020, Këshilli filloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve me Vendimin nr. 55, datë 16.02.2021.

18. Siç u parashtrua, sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 83, datë 26.02.2020, kjo procedurë kishte pesë kandidatë: 1) Znj. Manjola Xhaxho, 2) Z. Dhimitër Lara, 3) Z. {...}, 4) Znj. Klodiana Veizi dhe 5) Z. Sokol Ibi.

18.1 Ndërkohë kandidati z. Sokol Ibi, në vijim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë është tërhequr nga kandidimi për të dyja pozicionet dhe Këshilli me vendimet e tij nr. 318 datë 22.07.2021 dhe nr. 19 datë 17.01.2022 ka vendosur për përfundimin e të dyja procedurave të ngritjes në detyrë.

19. Sa sipër, procedura e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 83, datë 26.02.2020, vijoi për katër kandidatët e tjerë Znj. Manjola Xhaxho, Z. Dhimitër Lara, Z. {...} dhe Znj. Klodiana Veizi për të cilët ishte verifikuar plotësimi i dy kërkesave të ligjës për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, ka përfunduar procedura e verifikimit, si dhe për ta ka dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në shkronjën “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

20. Në përfundim të procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 84, datë 09.07.2020, mbështetur në nenet 136, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 85, 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 12 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin Paraprak të Propozimit për Emërim nr. 61, datë 15.02.2022, vendosi:

1. *Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:*

- 1) Z. {...};
- 2) Znj. Manjola Xhaxho;
- 3) Znj. Klodiana Veizi; Z. Dhimitër Lara

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...}.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve z. {...}, znj. Manjola Xhaxho, znj. Klodiana Veizi dhe z. Dhimitër Lara, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

21. Ky vendim, iu njoftua rregullisht, më datë 15.02.2022, në rrugë elektronike, kandidatëve z. {...}, znj. Manjola Xhaxho, znj. Klodiana Veizi dhe z. Dhimitër Lara, të cilët, bazuar në pikën 12, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

22. Kandidatët znj. Manjola Xhaxho dhe z. Dhimitër Lara kanë ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mësipërm, duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

22.1 Pas shqyrtimit të padisë së paraqitur nga kandidati znj. Manjola Xhaxho, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 18 datë 01.03.2022 ka vendosur : Rrëzimin e padisë.

22.2 Pas shqyrtimit të padisë së paraqitur nga kandidati nga z. Dhimitër Lara, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 20 datë 01.03.2022 ka vendosur : Rrëzimin e padisë.

23. Me datë 01.03.2022 u kërkuar informacion në rrugë elektronike nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë lidhur me faktin nëse ndaj Vendimit Paraprak të Propozimit për Emërim nr. 61, datë 15.02.2022 të Këshillit, është ushtruar e drejta e ankimit nga dy kandidatët e tjerë z. {...} dhe Klodiana Veizi (Mema).

23.1 Po më datë 01.03.2022, në rrugë elektronike, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë konfirmoi faktin se ndaj Vendimit Paraprak të Propozimit për Emërim nr. 61, datë 15.02.2022 të Këshillit, nuk është paraqitur ankim nga dy kandidatët z. {...} dhe Klodiana Veizi (Mema).



24. Në kushtet si më lart, Vendimi Paraprak i Propozimit për Emërim nr. 61, datë 15.02.2022, ka marrë formë të prerë, duke u shndërruar kështu në vendim përfundimtar.

### **III. MBI PLOTËSIMIN E KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË, NGA KANDIDATI Z. {...}**

25. Siç u parashtrua, plotësimi i kriterëve të kandidimit nga kandidati z. {...}, u verifikua nga Këshilli me Vendimin nr. 216, datë 18.06.2020 (*për tre kriteret formale të kandidimit*) dhe, më pas, edhe me Vendimin final nr. 600, datë 04.12.2020.

26. Konkretisht, për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi i kriterit (kushtit) të *“përvojës minimale profesionale”*. Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar: Shkresa nr. 2138/1 prot., datë 18.05.2020 e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor; Shkresa nr. 376 prot., datë 20.05.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

26.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati plotëson kriterin (kushtin) e përvojës së përgjithshme minimale profesionale, ndërsa ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit për më shumë se 13 vjet. Kandidati ka përfunduar formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës. Në bazë të Ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996, *“Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 4320, datë 17.09.2004, është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërsa me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 4655, datë 03.10.2005, ai është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8253 datë 16.07.2013, Dekret i cili ka hyrë në fuqi me datën 04.11.2013, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku vijon të ushtrojë funksionin dhe aktualisht.

26.2 Po për kriterin e *“përvojës minimale profesionale”*, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati plotëson edhe përvojën specifike minimale profesionale, ndërsa ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në fushën e të drejtës administrative, për më shumë se 5 vjet.

27. Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*. Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar: Shkresa nr. 2138/1 prot., datë 18.05.2020, e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Formulari i Vetëdeklarimit *“Për masa disiplinore”*, datë 20.05.2020, depozituar nga kandidati në momentin e kandidimit, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

27.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi.

28. Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*. Për verifikimin e këtij kriteri është administruar Formulari i Vetëdeklarimit *“Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, datë 20.05.2020, depozituar nga kandidati në momentin e kandidimit, ku ka deklaruar se *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

28.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati nuk do të ndodhej në situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin, nëse do të ngrihej në detyrë/emërohej në Gjykatën e Lartë.

29. Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterëve të *“pasurisë”* dhe të *“figurës”*.

29.1 Për këto kriterë, në nenin 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”*. Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, janë subjekt rivlerësimi kalimtar *“ex officio”*, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. Kështu, në këtë akt nënligjor, Këshilli parashikoi rregulla specifike edhe për gjyqtarët që kandidonin për ngritjen në detyrë, të cilët i ishin nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe ishin konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të tij, përcaktohet se: *“1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, ..., për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit*

*kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar*”. Sa më sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sikundër edhe procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas nenit 32 të Ligjit për Statusin, kjo për periudhën pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit.

34. Për verifikimin e kriterit të “*pasurisë*” janë administruar: Vendimi nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi me Vendimin nr. 21, datë 13.09.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; Akti i Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë nr. 195/24 prot., datë 25.06.2020, i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Interesave Private; Shkresa nr. 8498/1 prot., datë 03.06.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; Shkresa nr. 9228/1 prot., datë 28.05.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

34.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati ka kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referuar për këtë Vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi me Vendimin nr. 21, datë 13.09.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

34.2 Po ashtu, për këtë kriter, sa i përket periudhës pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se:

- a) *kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;*
- b) *kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;*
- c) *kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;*
- ç) *deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.*

35. Për verifikimin e kriterit të “*figurës*” janë administruar: shkresat nga shërbimet shtetërore informative; Shkresa nr. 2334/1 prot., datë 27.05.2020, e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

35.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar, sikurse u përmend, është konstatuar se kandidati ka kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

35.2 Po ashtu, për këtë kriter, sa i përket periudhës pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se për kandidatin nuk identifikohet dhe verifikohet ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

35.3 Në vijim, për këtë kriter, në kushtet kur kandidati ka qenë magjistrat/gjyqtar në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Struktura e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Shkresën nr. 2334/1 prot., datë 27.05.2020, ku për kandidatin {...} është bërë me dije se:

- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 03.05.2016;
- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web;
- në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji;
- nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruar;
- deri më sot nuk ka patur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

35.4 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;

- c) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij, mbi të cilat mund të gjykohet për pranueshmërinë e tij për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

#### **IV. KONKLUZIONE**

36. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati z. {...}, në kushtet kur plotëson kriteret e kandidimit për emërim në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 83, datë 26.02.2020, duhet t'i propozohet Presidentit të Republikës për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

37. Për arritjen në përfundimin si më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti në konsideratë faktin se Vendimi Paraprak i Propozimit për Emërim nr. 61, datë 15.02.2022, pas njoftimit rregullisht kandidatëve, të cilët gëzonin të drejtën e ankimit ndaj tij, tashmë është shndërruar në vendim përfundimtar, pas shqyrtimit nga Gjykata Administrative e Apelit të ankimeve të paraqitura nga kandidatët e procedurës së përzgjedhjes lidhur me këtë vendim. Sipas vendimit nr. 61, datë 15.02.2022, kandidati që do të duhej të propozohej për emërim në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 83, datë 26.02.2020, ishte z. {...}.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në nenin 147 dhe në shkronjën “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 2, të nenit 85 dhe në shkronjën “ë”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 11, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IX, të Vendimit të tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor

## **VENDOSI:**

1. T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**